



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E PROKURIMIT

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i AK-së në bazë të Nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke vendosur sipas Kërkesës së Parashtruar për Rishqyrtim të dt.30.11.2021 nga Operatori Ekonomik, “**MATKOS Pharm**”SH.P.K. nga Prishtina, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit “**Furnizimi dhe montimi i paisjeve mjekësore**”-Llot 1 me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-21-7103-1-1-1, nxjerrë këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pa bazuar - Kërkesa për Rishqyrtim të dt. 30.11.2021, parashtruar nga Operatori Ekonomik, “**MATKOS Pharm**”SH.P.K. nga Prishtina, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit “**Furnizimi dhe montimi i paisjeve mjekësore**”-Llot 1 me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-21-7103-1-1-1, Kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të dates, 24.11.2021 të publikuar përmes platëformës së e-prokurimit dhe të ueb-faqes së KRPP-ës.

Vërtetohet; Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të Aktivitetit të Prokurimit të datës 24.11.2021, të publikuar përmes platëformës së e-prokurimit dhe të ueb-faqes së KRPP-ës.

AK - Ka pezulluar; Aktivitetin e prokurimit me dt.30.11.2021 dhe ka publikuar për të gjitha palët në platformën elektronike të e-prokurimit në ueb-faqën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

AK- Qëndron prapa, Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Ky **Vendim** hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike të e-prokurimit në ueb-faqën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetimi

Operatori Ekonomik, “**MATKOS Pharm**”SH.P.K. nga Prishtina, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit “**Furnizimi dhe montimi i paisjeve mjekësore**”-Llot 1 me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-21-7103-1-1-1, Kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të dates, 24.11.2021, Pas analizimit të pretendimit ankimore, AK ka konstatuar se kërkesa për rishqyrtim është e pa bazuar dhe se pretendimi ankimorë nuk qëndronë:

- Pas vendimit të AK-së, ju keni kërkuar qasje në dokumentacionin e OE të rekomanduar për kontratë me dt.24.11.2021 ku ju kemi dhënë çasje por që në fillim ju kemi treguar dhe ju kemi dorzuar Aneksin 3, që OE i rekomanduar për kontratë e ka plotësuar **Kërkesën për Sekret Afarist**, pra nuk lejohet të ketë qasje në disa dokumente sipas nenit 68 dhe 69 të LPP-së, por qasje ju kemi dhënë në dokumentet tjera të lejuara që nuk kanë qenë në sekret afarist.

Pretendimi i prashtruar i kërkesës për rishqyrtim të OE “MATKOS Pharm” Shpk.:

- Pas shqyrtimit të dokumentave që në të cilat kemi patur qasje, kemi vrejtur se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar katalogun sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Ndërsa ka dorëzuar një katalog të përgjithshëm dhe sipas Deklarates së kërkuar nga AK-ja,

Kompania “MADEKOS” me seli në Prishtinë, deklaron se ne tenderin e lartpërmendur nuk egziston katalog vetem per kete tender por kemi katalogun gjeneral ku deklarojm se do të bejme liferimin ne perputhje me standardet europiane dhe specifikat e kerkuara te dosjes së tenderit.

Sipas juve pergjigjeja e OE të rekomanduar për kontratë shihet që nuk ka dorëzuar katalog apo brushurë për artikujt e ofruar por ka prezentuar katalog të përgjithshëm.

Përgjigjeje nga AK-ja :

- Që në fillim të gjitha ofertat janë vlerësuar dhe egzaminuar sipas LPP-së dhe qështja e katalogut është krejtësisht në rregull sepse OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar katalogun e shumë prodhuesve dhe jo të vetëm një prodhuesi e ku në te janë të gjitha specifikat e kërkuara në dosjen e tenderit gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë në oferten e tij ka plotësuar edhe deklaratën që i përmbahet të gjitha specifikave të kërkuara në DT.

Edhe pse për Autoritetin Kontraktues ishte gjithçka në rregull në lidhje me katalogun dhe specifikat dhe deklaratën e mbushur në DT, ne prap se prap i kërkuem sqarime shtesë.

Kompania “MADEKOS” ju përgjigj duke na e derguar edhe një deklaratë, ku thotë se e kemi dorëzuar katalogun gjeneral të përgjithshëm e të shumë prodhuesve që i përfshijnë specifikat e kërkuara të DT dhe ku deklarojnë se liferimin do ta bëjmë në përputhje me specifikat e kërkuara dhe me standarde europiane.

Ndërsa katalogu në oferten e juaj dhe në të gjitha ofertat e operatorve tjerë konkurues nuk i kanë patur të gjitha specifikat e kërkuara sepse ishin katalogje të një furnizuesi, andaj një furnizues nuk mund të e ket të gjitha specifikat e kërkuara siç e keni cekur edhe ju vet, por ne e kemi konsideruar se në bazë të deklaratave për specifika teknike të ofruara do të i përmbaheni të gjitha specifikave të kërkuara në DT. Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar katalog të përgjithshëm prej shumë furnizuesve dhe po ashtu pjesë përbërse e kontratës është sigurimi i ekzekutimit gjithashtu deklaron se i përmbahet specifikave teknike sikur ju dhe ofertuesit tjerë dhe gjithashtu ka çmimin më të ulët se oferta juaj e dytë dhe ofertat tjera të renditura sipas çmimit.


- Pas analizimit te pretendimit ankimore, AK ka konstatuar se kërkesa për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të dates 24.11.2021, konsiderohet se është e pabazuar për arsye se pretendimi ankimorë **nuk qëndronë**.

- Andaj AK qendron prapa Njoftimit Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Nga se u cek, në bazë të Ligjit nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin 05/l-092, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në institucionet tjera kompetente në pajtim me nenin 109 te LPP-se

Nr. 14-370/01-0105715/21
Dt.03.12.2021
Podujevë



Menaxheri ZP
Rasim Fejza

[Handwritten signature]